

Mars//2002

KOMENTARI

i Dekretit nr. 3702, datë 08.07.1963

“PËR ÇEKUN”,

**dhe ligjit 7782 datë 26.01.1994 “Për disa shtesa dhe
ndryshime në dekretin nr. 3702 datë 08.07.1963 “Për Çekun”.**

Tiranë, 2002

P R E A M B U L

Dektretligji “Për çekun”, nr. 3702, datë 08.07.1963, së bashku me amendamentet e tij, bërë me ligjin nr. 7782, datë 26.01.1994 “Për disa shtesa dhe ndryshime në dekretin nr. 3702, datë 08.07.1963 “Për çekun” – referuar më poshtë si “ligji”, janë baza ligjore kryesore që përcaktojnë dhe organizojnë përdorimin dhe funksionimin e çekut si mjet pagese me bazë letër, dhe ndër burimet kryesore të së drejtës në fushën e sistemit të pagesave.

Ligji është i konceptuar dhe përmban koncepte “bazuar në letër”, të tillë siç janë “të shkruarit”, “firma”, “posedimi,” të cilat nuk janë të rëndësishme dhe nuk funksionojnë në një “ambient elektronik”.

Në këtë komentuar nuk është bërë komenti për çdo paragraf të çdo neni, por, janë komentuar vetëm ato paragrafe dhe ato nene, që janë gjykuar se kanë nevojë për koment ose mund të ketë grupim nenesh në një koment të përbashkët (për nene që kanë të njëjtin objekt).

KREU I

LËSHIMI DHE FORMA E ÇEKUT

Neni 1

Çeku duhet të përmbajë:

- a) tregimin e emrit “çek” të shkruar po në atë gjuhë në të cilën është shkruar edhe teksti i tij;**
- b) porosinë pa asnjë kusht për të paguar një shumë të caktuar;**
- c) emrin e atij që është caktuar për të paguar (pritësit);**
- ç) tregimin e vendit, ku do të bëhet pagimi;**
- d) tregimin e vendit, të ditës, muajit dhe vitit të lëshimit të çekut;**
- dh) nënshkrimin e atij që lëshon çekun (lëshuesit).**

Koment :

Çeku është një dokument që përmban urdhrin e pakushtëzuar të një personi (lëshuesit) drejtuar një banke për të paguar në të parë, një shumë të përcaktuar parash në favor të një të treti, të vetë lëshuesit ose të prurësit.

Çeku përmban porosinë, nga ana e lëshuesit, për pagimin e shumës nga pritësi dhe kjo porosi zbatohet pa asnjë kusht nga ana e pritësit. Pritësi është banka që paguan çekun. Porosia pa asnjë kusht mund të merret edhe si mosvënie e kushteve edhe nga ana e lëshuesit të çekut që jep porosinë, pra, porosia pa asnjë kusht nënkupton që asnjëra nga palët nuk do të ketë të drejtën të vërë ndonjë kusht mbi çekun, kjo pasi, çdo gjë e lidhur me çekun, është përcaktuar në dispozitat përkatëse të ligjit.

Me shprehjen “për të paguar”, kuptohet detyrimi i pritësit për të zbatuar porosinë e lëshuesit për pagimin e çekut.

Çeku që lëshohet përmban dy raporte (marrëdhënie) :

- Raportin ndërmjet lëshuesit dhe bankës së tij, lëshuesit, që justifikon urdhrin që lëshuesi i jep bankës, nëpërmjet lëshimit të çekut.

- Raportin e vlerës (shumës) që vendoset ndërmjet lëshuesit dhe përfituesit, në fazën e lëshimit ose në fazën e kalimit ndërmjet të parit dhe të dytit përfitues, ndërmjet të dytit dhe të tretit, dhe kështu me rradhë, për efekt të të cilit, i pari i premtos të dytit pagesën e shumës të shënuar në çek.

Karakteristika të çekut:

1. Çeku ka formën e një urdhri të pakushtëzuar, për pagesë të një personi në një bankë, në të cilën ka një llogari rrjedhëse.
2. Çeku ka strukturë formale të ngjashme me kambialin.
3. Subjektet fillestare të tij janë tre:
 - lëshuesi, që shkruan në titull një urdhër të pakondicionuar për të paguar një shumë të përcaktuar;
 - pritësi, që është banka e përcaktuar për të paguar çekun;
 - përfituesi, që është personi për të cilin ose në urdhër të të cilit duhet të bëhet pagesa. Lëshuesi dhe përfituesi mund të jenë edhe i njëjti person.
4. Lëshuesi duhet të ketë domosdoshmërisht një raport llogarie me bankën paguese.
5. Çeku mund të lëshohet bosh, pa patur fonde të mjaftueshme në llogari, por që të paguhet domosdoshmërisht duhet të ketë fonde në llogari.

Neni 2

Dokumenti në të cilin mungon qoftë edhe një nga elementet e treguara në nenin e mëparshëm nuk vlen si çek përveç rasteve të caktuara në paragrafët e mëpasëm. Në mungesë të një tregimi të veçantë, vendi i treguar afër emrit të pritësit quhet si vend i pagimit.

Në qoftë se shumë vende janë treguar afër emrit të pritësit, çeku është i pagueshëm në vendin që tregohet i pari.

Në mungesë të këtyre tregimeve ose të çdo tregimi tjetër, çeku është i pagueshëm në vendin në të cilin pritësi ka qendrën e tij kryesore.

Çeku, në të cilin nuk tregohet vendi i lëshimit të tij quhet se është lëshuar në vendin e treguar afër emrit të lëshuesit.

Neni 3

Pritësi i çekut mund të jetë vetëm një institucion krediti. Por, megjithëkëtë, kur çeku i lëshuar në Republikën e Shqipërisë do të paguhet jashtë shtetit, si pritës i

çekut mund të jetë çdo person që, sipas ligjit të vendit të pagimit, pranohet si pritës.

Nuk mund të lëshohet çek në rast se lëshuesi nuk ka fonde të disponueshme pranë pritësit, të cilat mund t'i disponojë me anë çeqesh dhe në pajtim me një marrëveshje të shprehur ose të heshtur.

Megjithëkëtë, dokumenti vlen si çek edhe sikur të mos të jenë mbajtur këto rregulla.

Koment:

Me institucion krediti do të kuptohen institucionet, sipas përcaktimit të dhënë në nenin 54 të këtij ligji, ndërkohë që në praktikë njihen vetëm çeqe të lësuara mbi një bankë.

Çeku nuk mund të lëshohet nëse lëshuesi nuk ka fonde të disponueshme në llogarinë e tij pranë bankës pritëse. Lëshuesi duhet të ketë domosdoshmërisht një llogari me bankën. Pavarësisht se kjo mangësi nuk evidentohet që në momentin e prezantimit të çekut në bankë, në faza të mëpasme të procesimit të çekut, mungesa e njërit apo e tjetrit element, mund të sjellë ndalimin e procesimit të mëtejshëm të tij.

Neni 4

Çeku nuk mund të pranohet.

Çdo shënim për pranimin e tij, i vënë mbi çekun quhet se nuk është shkruar.

Çdo shënim vërtetimi, konfirmimi ose i çdo veprimi tjetër të tillë, i bërë në dokumentin dhe i nënshkruar nga pritësi, ka efekt vetëm që të vërtetojë ndodhjen e fondeve dhe të ndalojë tërheqjen e tyre nga ana e lëshuesit para mbarimit të afatit të paraqitjes.

Koment:

Koncepti i mosshprehjes së “pranimit të çekut” mbi çek, nga ana e pritësit, tregon se ky i fundit nuk ka të drejtë “të pranojë” çekun siç bëhet për shembull te “kambiali” (te kambiali pranimi shkruhet mbi kambial – neni 25 i ligjit “Për kambialin dhe premtim-pagesën”). Ky është një nga dallimet që ekzistojnë mes çekut dhe kambialit. Përsa më sipër, tek çeku, pritësi (banka) nuk është debitor dhe për këtë arsye mbetet “jashtë” në marrëdhëniet mes lëshuesit dhe përfituesit të çekut.

Neni 5

Çeku mund t'i paguhet:

- a)një personi të caktuar me ose pa shënim “në urdhër”;**
- b)një personi të caktuar me shënimin “jo në urdhër”;**
- ç)prurësit.**

Çeku në dobi të një personi të caktuar, që përmban shënimin “ose te prurësi” ose ndonjë shprehje tjetër me të njëjtin kuptim vlen si çek te prurësi.

Çeku, që nuk shënon personin të cilit i duhet paguar vlen si çek tek prurësi.

Personat juridikë dhe fizikë, shqiptarë dhe të huaj, lëshojnë vetëm çeqe që mund t'i paguhet një personi të caktuar me shënimin “jo në urdhër”.

Personat juridikë e fizikë të huaj veprojnë sa më sipër kur çeqet i lëshojnë mbi llogaritë e tyre bankare që kanë në Republikën e Shqipërisë.

Koment :

Titujt “në urdhër” janë tituj që marrin emrin e mbajtësit të së drejtës, i cili është marrësi i parë apo subjekti të cilit titulli i transferohet më pas. Titujt në urdhër xhirohen nëpërmjet dorëzimit të titullit me anë të xhimit (i cili transferon të gjitha të drejtat e titullit). Xhimi përbëhet nga një deklaratë, e shkruar mbi titull, me anë të së cilës xhiruesi (marrësi apo lëshuesi i mëpasshëm) “urdhëron” emetuesin debitor të kryejë huadhënien në favor të marrësit (përdoruesit) të cilit i transferohet pronësia e titullit. Mbajtësi i një titulli në urdhër ka të drejtën legjitime në ushtrimin e të drejtës që mban titulli në bazë të një serie të vazhdueshme urdhërtransferimesh, e drejtë që lind kur urdhri në secilin urdhërtransferim, i referohet atij që rezulton si përfitues i urdhërtransferimit të mëparshëm. Tituj në urdhër janë kambiali, çeku. Në këtë nen janë përcaktuar katër lloje çeqesh që mund të paguhet nga ana e pritësit :

1. Çeku me shënimin “në urdhër” është një çek që mund të xhirohet.
2. Çeku me shënimin “jo në urdhër” nuk mund të xhirohet. Ai i paguhet vetëm një personi të caktuar.
3. Çeku me shënimin “ose tek prurësi” përdoret kur është përcaktuar personi, por mund t'u kalojë edhe të tjerëve.
4. Çeku i bardhë ku nuk shënohet personi, është çek “tek prurësi”.

Praktika tek ne njih çeqet e lëshuara “në urdhër” sipas pikës (a) të këtij neni. Në fakt, po këto çeqe janë të trajtuara si çeqe “jo në urdhër”, domethënë sipas pikës (b) të nenet. Kontradikta në këtë rast qëndron mes formës së shkruar të çekut, pra, nuk plotësohet kërkesa e ligjit për vënien e shënimit “jo në urdhër”, dhe mënyrës së përdorimit të tij si çek “jo në urdhër” .

Neni 6

Çeku mund të jetë me urdhër të vetë lëshuesit.

Çeku mund të lëshohet për llogari të një të treti.

Çeku nuk mund të lëshohet mbi lëshuesin vetë, përveç kur dokumenti është lëshuar midis degëve të të njëjtit lëshues. Në këtë rast nuk mund të jetë të prurësi.

Koment:

Paragrafi i parë i këtij neni, përcakton rastin kur lëshuesi i çekut, mund të përdorë çekun për të tërhequr një sasi parash nga llogaria e tij bankare.

Paragrafi i dytë, në të kundërt, i referohet një situatë tepër të kufizuar të përdorimit praktik, lidhur me rastin në të cilin lëshuesi autorizohet nga një palë e tretë të shkruajë dhe, të lëshojë çekun në llogarinë e bankës të kësaj pale të tretë.

Në paragrafin e tretë, për shembull Banka e Shqipërisë mund të japë çeqe pagë vetëm në emër të punonjësve të saj dhe jo të bankave të tjera, pra, çeku nuk mund të lëshohet mbi lëshuesin vetë, vetëm nëse është lëshuar midis degëve të ndryshme të të njëjtit lëshues. Domethënë, çeqet e lëshuara në këtë rast, përcaktojnë personin (prurësin), pra, nuk janë çeqe tek prurësi, në të cilat nuk shënohet personi.

Emetimi i çekut bëhet në urdhër të vetë lëshuesit, të prurësit dhe në urdhër të një të treti.

Neni 7

Çdo premtim kamate, i vënë në çek, quhet se nuk është shkruar.

Koment :

Në koment të këtij neni mund të sqarohet se, çdo shënim për përfitim interesi në lidhje me çekun (i vënë mbi çek), është nul dhe nuk konsiderohet.

Neni 8

Çeku mund të paguhet në banimin e një të treti, qoftë në vendin e banimit të pritësit, qoftë në një vend tjetër, por me kusht që i treti të jetë një institucion krediti.

Koment :

Ky nen, ka lidhje me nenin 3. Kushti i vetëm dhe i domosdoshëm është që çeku të paguhet në një bankë (nga një bankë).

Neni 9

Çeku në të cilin shuma për t'u paguar është shkruar me shkronja dhe me shifra, në rast ndryshimi, ka vleftë për shumën e shkruar me shkronja.

Në qoftë se shuma për t'u paguar është shkruar shumë herë me shkronja dhe me shifra, në rast ndryshimi, çeku ka vleftë për shumën më të vogël.

Koment:

Ky nen konsiderohet i qartë. Megjithatë, për paragrafin e dytë, praktika e deritanishme nuk pranon çeqe të shkruara me gabime ose çeqe të shkruara disa herë.

Neni 10

Kur çeku përmban nënshkrime të personave që nuk kanë zotësi të marrin detyrime me çek, nënshkrime fallco ose të personave të imagjinuar, ose nënshkrime që për çdo arsye tjetër nuk detyrojnë personat që kanë nënshkruar çekun, ose që me emrin e të cilëve çeku është nënshkruar, detyrimet e nënshkruesve të tjerë janë gjithmonë të vlefshme.

Koment:

Këtu bëhet fjalë për ato kategori personash, të cilët nuk mund të marrin detyrime me çek:

- Personat, të cilët nuk kanë zotësi juridike dhe zotësi për të vepruar (sipas

dispozitave të Kodit Civil) ose që me një vendim gjyqësor të formës së prerë ju është kufizuar ose hequr kjo zotësi;

- personat, nënshkrimet e të cilëve rezultojnë false, ose personat imagjinarë (joekzistentë);
- çdo kategori tjetër personash që kanë nënshkruar por që nuk kanë detyrime mbi çekun.

Janë të vlefshme të gjitha detyrimet e tjera që rrjedhin nga nënshkrimi i rregullt i çekut.

Neni 11

Çdo nënshkrim duhet të përmbajë emrin dhe mbiemrin ose firmën tregtare të atij që merr detyrimin. Megjithatë, është i vlefshëm nënshkrimi në të cilin emri është shkurtuar ose është treguar vetëm me shkronjën e parë.

Koment:

Në këtë nen përcaktohen rastet kur është e detyrueshme firma e atij që merr detyrimin.

Nënshkrimet në çek janë :

- Për subjektet: emërtimi i plotë, i shkurtuar ose vula dhe nënshkrimet e autorizuara.
- Për individët : emri, mbiemri, firma.

Nuk përcaktohet detyrimi i këtij personi për të nënshkruar gjithmonë, sepse ka raste që ai nuk nënshkruan (per shembull tek neni 16).

Neni 12

Kushdo që vë nënshkrimin e tij në një çek si përfaqësues i një personi për të cilin nuk ka të drejtë të vepronë, si dhe përfaqësuesi që kapërcen kufijtë e të drejtave që i janë dhënë janë përgjegjës në bazë të çekut, sikur do ta kishin nënshkruar çekun për veten tyre dhe, në qoftë se kanë paguar kanë të gjitha të drejtat që do të kishin të përfaqësuarit e tyre.

Koment :

Ky nen rregullon marrëdhënien kur një çek nënshkruhet nga një person (përfaqësuesi) në emër dhe për llogari të një personi tjetër (të përfaqësuarit), pa autorizim ose prokurë, në dy raste:

- përfaqësuesi ka vepruar pa autorizim ose prokurë për të përfaqësuar një person;
- përfaqësuesi kapërcen tagrat që i përfaqësuari i ka dhënë, në autorizimin ose në prokurën e tij.

Në të dyja këto raste, përfaqësuesi është i detyruar dhe përgjigjet për çekun, sikur të kishte nënshkruar çekun për vete (për llogari të tij).

Neni 13

Lëshuesi i çekut përgjigjet për pagimin e tij. Çdo shënim me të cilin lëshuesi përjashtohet nga kjo përgjegjësi quhet se nuk është shkruar.

Koment:

Në të gjitha rastet, personi që nënshkruan çekun (lëshuesi i çekut), është përgjegjës për pagimin e këtij çeku të nënshkruar (lëshuar).

KREU II

KALIMI I ÇEKUT NJË PERSONI TJETËR

Neni 14

Çeku te prurësi mund t'i kalojë një personi tjetër me dorëzimin e thjeshtë të tij.

Çeku, që duhet t'i paguhet një personi të caktuar me ose pa shënimin e shprehur “në urdhër” mund t'i kalojë një personi tjetër me anë të xhirimit.

Çeku, që duhet t'i paguhet një personi të caktuar me shënimin “jo në urdhër” ose me një shprehje tjetër me të njëjtin kuptim, mund t'i kalojë një personi tjetër, vetëm sipas dispozitave mbi kalimin e kredive.

Xhirimi mund të bëhet edhe në dobi të lëshuesit ose të çdo personi tjetër të detyruar. Këta mund ta xhirojnë rishtas çekun.

Kalimi një personi tjetër të çdo çeku tjetër në valutë të huaj në Shqipëri bëhet vetëm sipas dispozitave të veçanta mbi veprimet juridike në lidhje me arin dhe me valutën e huaj.

Koment:

Ky nen ka lidhje me nenin 5. Çeqet me shënimin “jo në urdhër”, si rregull nuk xhirohen. Xhirimi i tyre bëhet vetëm sipas dispozitave të veçanta të kalimit të kredive (marrëdhëniet debitor-kreditor – Kodi Civil mbi detyrimet). Kreditori (prurësi), mund t'i kalojë çekun (kredinë) një personi tjetër, edhe pa miratimin e debitorit (lëshuesit). Parë nga këndvështrimi juridik, çeku ka strukturën e delegimit (kalimit, transferimit, xhiritimit) të pagesës.

Xhirimi i çekut në urdhër kryhet nëpërmjet dorëzimit material të tij. Në formën e tij më komplete, xhirimi konsiston në një urdhërpagimi dhënë nga xhiruesi bankës për të paguar një të tretë, të xhiruarin, ndaj të cilit transferohet pronësia e titullit. Xhirimi mund të jetë dhe në të bardhë, pra pa asnjë lloj tregimi të emrit të të xhiruarit.

Neni 15

Xhirimi duhet të jetë pa kushte. Çdo kusht nga i cili varet xhirimi quhet se nuk është shkruar.

Xhirimi i pjesshëm është i pavlefshëm.

Gjithashtu, është i pavlefshëm xhirimi i pritësit.

Xhirimi që i bëhet prurësit vlen si një xhirim në të bardhë.

Xhirimi që i bëhet pritësit vlen si dëftesë pagimi, përveç kur pritësi ka shumë degë dhe xhirimi i bëhet një dege të ndryshme nga ajo që është caktuar për të paguar çekun.

Koment :

Nuk duhet vënë asnjë kusht për xhirimin. Xhirimi bëhet për shumën e plotë të çekut. Banka, si pritëse e çekut, nuk ka të drejtë ta xhirojë atë. Xhirimi në të bardhë quhet xhirimi i thjeshtë që bën prurësi për një person tjetër, pra, e xhiron dhe e nënshkruan çekun.

Në paragrafin e fundit të nenit “xhirimi që i bëhet pritësit ...”, nuk është fjala për xhirimin, në kuptimin e mësipërm, por lidhet me momentin kur bëhet thyerja e çekut në bankë dhe çeku në këtë rast vlen si dëftesë pagimi. Çeku nuk vlen si dëftesë pagimi kur pritësi ka shumë degë dhe çeku paguhet (xhirohet) në një degë të ndryshme nga ajo që është caktuar për ta paguar.

Neni 16

Xhirimi duhet të jetë shkruar mbi çekun ose në një fletë që i bashkohet çekut (zgjatje). Xhirimi duhet të jetë nënshkruar nga xhiruesi.

Xhirimi është i vlefshëm edhe sikur personi, në dobi të të cilit është bërë, të mos tregohet ose xhiruesi të ketë vënë vetëm nënshkrimin e tij (xhirimi në të bardhë).

Në këtë rast, xhirimi, që të jetë i vlefshëm duhet të jetë shkruar në shpinën e çekut ose në zgjatjen.

Koment:

Xhirimi i çekut mund të paraqitet në dy mënyra :

1. Mund të jetë shkruar mbi çekun (nënshkrim i xhiruesit si xhirim në të bardhë).
2. Mund të shkruhet në një fletë më vehte, që i bashkohet çekut (zgjatja) e cila nuk ka ndonjë element tjetër, përveç nënshkrimit të xhiruesit.

Nëse personi, në dobi të të cilit është bërë xhirimi, nuk vendos nënshkrimin e tij për xhirimin (pasi kjo nuk është e detyrueshme), xhiruesi duhet të nënshkruajë patjetër në shpinën e çekut ose në pjesën zgjatuese të tij.

Neni 17

Me xhirimin i kalojmë një personi të gjitha të drejtat që rrjedhin nga çeku.

Kur xhirimi është në të bardhë, mbajtësi i çekut ka të drejtë:

- a) të mbushë xhirimin në të bardhë në emrin e tij ose në emrin e një personi tjetër;
- b) t'ja kalojë çekun një personi tjetër me anë të xhirimit në të bardhë ose me anë të xhirimit në emër të këtij personi të caktuar;
- ç) t'ja kalojë çekun një të treti, pa mbushur xhirimin në të bardhë ose pa bërë xhirim.

Neni 18

Xhiruesi, në qoftë se nuk është vënë ndonjë kusht i kundërt, përgjigjet për pagimin e çekut. Ai mund të ndalojë një xhirim të ri; në këtë rast, nuk është përgjegjës kundrejt atyre të cilëve çeku u ka kaluar me xhirim më pas.

Koment:

Xhiruesi (që mund të jetë si prurës ashtu dhe lëshues) përgjigjet për pagimin e çekut pasi në momentin që bëhet xhirimi, personi në favor të të cilit bëhet ky xhirim, ka të drejtën legjitime të mos ketë asnjë pengesë në procesin e pagimit të çekut, dhe i pari që do të përgjigjet për pagimin do të jetë ai që ja ka xhiruar këtë çek (xhiruesi).

“Xhiruesi mund të ndalojë një xhirim të ri ...” me këtë kuptohet përfundimi i xhimit, pra procesi në të cilin xhiruesi i fundit ja paraqet çekun pritësit për pagesë dhe në këtë mënyrë çeku përfundon së xhiruari.

Neni 19

Mbajtësi i çekut, që i kalohet tjetrit me anë xhirimi, quhet se është prurës i ligjshëm në qoftë se justifikon të drejtën e tij me një sërë të vazhdueshme xhirimesh, edhe sikur xhirimi i fundit të jetë i bardhë.

Xhirimet e hequra (shfuqizuara) në këtë rast quhen si jo të shkruara.

Në rast se pas xhimit në të bardhë ka një xhirim tjetër, quhet se nënshkruesi i këtij xhirimi të fundit e ka fituar çekun me anën e xhimit në të bardhë.

Koment:

Në çdo moment, mbajtësi i çekut që e ka fituar atë (çekun) me anë xhirimesh të rregullta të njëpasnjëshme, qoftë dhe me xhirim në të bardhë, do të konsiderohet si prurës i rregullt dhe legjitim i çekut. Ai mund t’a xhirojë sërish këtë çek.

Neni 20

Xhirimi i vënë në një çek të prurësi e bën xhiruesin përgjegjës sipas dispozitave mbi të drejtën e kthimit, por dokumenti nuk kthehet në çek në urdhër.

Koment:

Xhirimi i vënë mbi një çek “tek prurësi”, është xhirimi që i bëhet çekut, mbi të cilin nuk shënohet personi të cilit i duhet paguar ky çek. Prurësi i çekut, në këtë rast, ka të drejtë të kërkojë nga xhiruesi, lëshuesi, dhe të detyruarit e tjerë, kthimin e shumës së paguar (e drejta e kthimit), në rast se çeku është paraqitur për pagesë dhe nuk është paguar nga pritësi (banka), por kjo nuk do të thotë që dokumenti të kthehet në çek “në urdhër”, ku përcaktohet personi përfitues (referuar komentit të neneve 52 dhe 53).

Neni 21

Në rast se një person, për çdo arsye, ka humbur posedimin e një çeku, prurësi i ri në duart e të cilit ka arritur çeku, qoftë kur çeku është te prurësi, qoftë kur i kalohet tjetrit me xhirim dhe kundrejt këtij prurësi justifikon të drejtën e tij në mënyrën e treguar në nenin 19, nuk është i detyruar që ta dorëzojë çekun përveç kur këtë e ka fituar në keqbesim, ose kur në fitimin e tij ka patur pakujdesi të rëndë.

Koment:

Në rast se një person ka humbur çekun ai njofton menjëherë bankën e tij. Personi që ka gjetur çekun, që mund të jetë çek "prurësit" ose çek i kaluar me anë xhirimesh, sipas nenit 19, nuk është i detyruar t'a dorëzojë çekun, në qoftë se nuk e ka fituar këtë çek në keqbesim, në mashtrim ose duke kryer ndonjë vepër të rëndë.

Neni 22

Personi kundër të cilit është ngritur padi në bazë të çekut, nuk mund t'i kundrejtojë prurësit të çekut prapësimet e themeluara në marrëdhëniet e tij personale me lëshuesin e çekut, ose me prurësit e mëparshëm të tij, përveç kur prurësi, në fitimin e çekut, ka vepruar me dijeni në dëm të debitorit.

Koment:

Në qoftë se një person ka gjetur një çek dhe kundër këtij personi është ngritur padi në bazë të çekut, ky person nuk mund t'i kundërdrejtojë prurësit të çekut prapësimet e themeluara që ai ka patur me lëshimin e çekut. Kjo përcakton rastin kur personi, që ka gjetur çekun, ka patur kontradikta me lëshuesin e çekut për shembull pretenduesi thotë se lëshuesi i çekut ka qënë debitor ndaj tij me një shumë të barabartë me atë të çekut, për këtë arsye ai pretendon për këtë çek, gje që nuk është e drejtë.

E kundërta ndodh nëse prurësi real i çekut ka vepruar me dijeni në dëm të debitorit. Në këtë rast pretenduesi i çekut mund t'i kundërdrejtojë atij me të drejtë pretendimet e tij për çekun.

Padia është mjeti juridik, me anë të të cilit personi i interesuar ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës në mënyrë që me anë të forcës shtrënguese të shtetit, të vërë në vend të drejtën e tij të përealizuar nga kontrata apo nga ndonjë marrëdhënie tjetër detyrimi.

Neni 23

Në rast se në xhirimin është vënë shënimi "vleftë për inkasim", "për inkasim", "me prokurë" ose çdo fjalë tjetër që tregon një porosi të thjeshtë, prurësi i çekut mund të ushtrojë të gjitha të drejtat që rrjedhin nga çeku, por nuk mund ta xhirojë përveç se me prokurë. Të detyruarit nuk mund t'i kundrejtojnë në këtë rast prurësit, përveç se prapësimet që do të mund t'i kundrejtonin xhiruesit.

Porosia që përmbahet në një xhirim me prokurë, nuk shuhet me vdekjen e porositesit ose me pazotësinë e tij për të vepruar të pasardhur.

Koment :

Shënimet "vleftë për inkasim", "për inkasim", "me prokurë", kanë vlerën e ndalimit të xhirit të çekut nga ana e prurësit. Ai mund t'a xhirojë çekun vetëm me prokurë. Në këto kushte, prurësi vepron në pozitën e xhiruesit dhe të detyruarit i drejtojnë atij prapësimet (reklamimet) që do t'i drejtonin xhiruesit.

Në rastin e një xhirimi me prokurë, e drejta për pagesën e çekut nuk shuhet, edhe në qoftë se lëshuesi (dhe/ose xhiruesi):

- ka vdekur (sepse ai (xhirimi) është kryer ndërkohë);
- pas lëshimit të çekut ka humbur zotësinë për të vepruar.

Neni 24

Xhirimi, që është bërë pas protestës, ose pas një konstatimi që ka të njëjtën vleftë, ose pas mbarimit të afatit për paraqitjen e çekut, sjell vetëm efektet e një kalimi të zakonshëm të kredisë.

Xhirimi pa datë, prezumohet, gjersa nuk provohet e kundërta, se është bërë para protestës ose konstatimit që ka të njëjtën vleftë, ose para mbarimit të afatit të treguar në paragrafin e mëparshëm.

Koment:

Protesta është akti që provon mospranimin ose mospagimin e një çeku në paraqitjen e tij për pagim. Protesta mund të kryhet për mospranim, për mospagim ose edhe për pranimit ose pagim jo të plotë, për pjesën e papranuar ose të papaguar.

Xhirimi i çekut mund të bëhet edhe pas protestës ose pas mbarimit të afatit për paraqitjen e çekut. Në këtë rast, sjell vetëm efektet e një kalimi të zakonshëm të kredisë.

KREU III

A V A L I

Neni 25

Pagimi i një çeku mund të sigurohet me aval për të gjithë shumën ose për një pjesë të saj.

Ky sigurim mund të jepet nga një i tretë, duke u përjashtuar pritësi ose edhe nga një nënshkrues i çekut.

Neni 26

Avali jepet mbi çekun ose mbi zgjatjen.

Avali shprehet me fjalët “për aval” ose me çdo tjetër formulë, që ka të njëjtën vleftë, dhe nënshkruhet nga avaluesi.

Quhet se aval i është dhënë me nënshkrimin vetëm të avaluesit, të vënë në faqen e parshme të çekut, por me kusht që ky nënshkrim të mos jetë i lëshuesit të çekut.

Avali duhet të tregojë për cilin është dhënë. Në mungesë të këtij tregimi, kuptohet se është dhënë për lëshuesin e çekut.

Neni 27

Avaluesi është i detyruar, po në atë mënyrë që është i detyruar ai për të cilin u dha aval.

Detyrimi i avaluesit është i vlefshëm edhe sikur detyrimi i siguar të jetë i pavlefshëm për çdo shkak tjetër që nuk është një mungesë forme.

Avaluesi, që paguan çekun fiton të drejtat që rrjedhin nga çeku kundër të siguarit me aval dhe kundër atyre që janë të detyruar ndaj tij për efekt të çekut.

Koment i neneve 25, 26 dhe 27

Avali (dorëzania) është një veprim juridik me anën e të cilit një person (avaluesi,

dorëzënësi) detyrohet që t'i sigurojë kreditorit përmbushjen e detyrimeve të një personi të tretë (debitorit kryesor) plotësisht ose pjesërisht. Ai vlen edhe nëse debitori nuk ka dijeni për këtë.

Avali është sigurimi, që do t'i bëhet dorëzimit dhe pagimit të çekut duke shkruar mbi çek ose tek zgjatja e tij "për aval" (neni 26 paragrafi 2). Avaluesi i çekut nuk mund të jetë lëshuesi i tij, por një person i tretë (neni 26, paragrafi 3).

Pagimi i çekut sigurohet nga avaluesi (që është person i tretë) për lëshuesin e çekut, por avalu mund të jepet edhe nga një nënshkruar i çekut (që ndoshta e ka fjalën për një xhirues), por jo nga banka pritëse, paguese (neni 26, paragrafi 3).

Avaluesi i çekut është i detyruar për çekun, njësoj si dhe lëshuesi i tij, me përjashtim të rastit kur çeku është i pavlefshëm për mungesë forme, për shembull është i demtuar fizikisht, i grisur (neni 27, paragrafi 2).

KREU IV

PARAQITJA DHE PAGIMI

Neni 28

Çeku është i pagueshëm në të parë. Çdo dispozitë e kundërt quhet se nuk është shkruar.

Çeku që paraqitet për pagim para ditës së treguar si datë e lëshimit të tij është i pagueshëm në ditën e paraqitjes.

Koment:

Kuptimi i "çeku është i pagueshëm në të parë", lidhet me pagimin e tij në bankën ku lëshuesi ka llogarinë e tij ose në ndonjë degë të kësaj banke, në të kundërt, çeku do të qarkullojë nëpërmjet sistemit bankar për tek banka lëshuese. Vënia e një date skadimi në çek, do të ishte e pa pajtueshme me natyrën e çekut, i cili është një instrument pagese, pasi do ta transformonte atë në një instrument krediti.

Ka raste kur ceku lëshohet me një datë të ardhme, dhe në këtë rast ai është i pagueshëm në ditën e paraqitjes, e cila mund të jetë dhe para datës së treguar në çek, që njihet si datë e lëshimit të tij.

Neni 29

Çeku duhet të paraqitet për pagim brenda 10 ditëve nga lëshimi i tij.

Çeku, që është lëshuar në një shtet të ndryshëm nga ai në të cilin është i pagueshëm, duhet të paraqitet, sipas rastit, brenda 2 ose 4 muajve, në qoftë se vendi i lëshimit dhe ai i pagimit janë në të njëjtin kontinent ose në kontinente të ndryshme.

Çeqet e lëshuara në një vend të Evropës dhe të pagueshëm në një vend bregdetar të Mesdheut, dhe anasjelltas, quhen si çeqe që janë lëshuar dhe janë të pagueshëm në të njëjtin kontinent.

Afatet e përmendura ecin nga dita e treguar në çek si datë e lëshimit të tij.

Koment:

Në kuptimin ekonomik, çeku, duke qënë një instrument pagese dhe jo kreditimi, duhet të paraqitet për pagim, brenda afateve sa më të shkurtra.

Mosprezantimi i çekut për pagesë, sipas afateve të treguara në paragrafin e parë të këtij neni, bën, që mbajtësi i çekut të humbasë të drejtën e kthimit kundrejt xhiruesve, nëse banka refuzon pagimin e çekut; por, mbetet detyrimi i lëshuesit mundësia për të përfituar pagesën nga banka (përsa kohë lëshuesi nuk ka tërhequr urdhrin për pagesën e përmbajtur në çek).

Neni 30

Në rast se çeku është lëshuar midis dy tregjeve që kanë kalendarë të ndryshme, data e lëshimit zëvendësohet me atë që i përgjigjet kalendarit të vendit të pagimit.

Neni 31

Paraqitja e çekut në një institucion që ka të drejtë të bëjë kompensimin reciprok të pagesave vlen njëllor si paraqitja për pagim.

Koment:

Çeku prezantohet në bankën ku klienti ka llogarinë e tij, ndërkohë që lëshuesi i çekut është klient i një banke tjetër. Në këtë rast, çeqet përpunohen nëpërmjet zyrës së klirimit të pagesave (klingu).

Çeqet bankare paguhen menjëherë ose mund të bëhen të vlefshme për tërheqje ditën tjetër të punës. Çeqet personale, që klirohen nëpërmjet kleringut bëhen të vlefshëm për tërheqje pas 3, 6 dhe 12 ditëve pas paraqitjes në klering, në varësi të vendit ku ndodhet banka paguese. Përderisa nuk kanë kaluar këto afate banka prezantuese vazhdon të jetë pronar i çekut derisa çeku të paguhet. Banka pranuese merr pagesën për çekun menjëherë me t'u paraqitur në klering (ku një grup bankash vinë së bashku çdo ditë për të shkëmbyer çeqet ndërmjet tyre) dhe për çeqet personale pret afatin e vlefshmërisë sipas zonave (përcaktuar me marrëveshjen ndërbankare nr. 5). Me kalimin e afateve, çeku konsiderohet i paguar përfundimisht dhe veprimet e kaluara në llogari përfundimtare.

Neni 32

Urdhri për të mos paguar shumën e çekut ka efekt vetëm pasi të ketë mbaruar afati i paraqitjes.

Në mungesë të një urdhri të tillë, pritësi mund të paguajë çekun edhe mbas mbarimit të afatit të përmendur.

Koment:

Ndërsa ka lëshuar një çek, lëshuesi, ka të drejtë të urdhërojë mospagimin e çekut, për një arsye të caktuar, pas mbarimit të afatit të paraqitjes të treguar në paragrafin e parë të nenit 29.

Banka paguan çekun edhe pas mbarimit të afatit të përmendur dhe në qoftë se nuk ka pasur një urdhër për mospagimin e tij.

Neni 33

Vdekja ose mbarimi i personit juridik që ka lëshuar çekun dhe humbja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar në të lëshuarit e çekut, e ardhur pas lëshimit të çekut, nuk sjellin asnjë ndryshim në efektet e çekut.

Koment:

Komentet për këtë nen, janë të njëjta me ato të bëra për nenin 23.

Neni 34

Pritësi që paguan çekun ka të drejtë të kërkojë që prurësi ti dorëzojë një dëftesë pagimi.

Prurësi nuk mund të mos pranojë një pagim të pjeshëm.

Në rast pagimi të pjeshëm, pritësi mund të kërkojë që për këtë të bëjë shënime në çek dhe t'i jepet dëftesë pagimi.

Koment:

Paraqitja e një çeku tek pritësi (banka) për t'u paguar, bëhet fizikisht dhe firmoset në pjesën e pasme të çekut (në zonën në shpinë të tij) nga përfituesi i tij.

Në qoftë se për shembull, bëhet një pagim i pjeshëm nga ana e pritësit, ky i fundit do të kërkojë nga prurësi dëftesën e pagimit për të vërtetuar se është bërë kjo pagesë e pjesëshme.

Neni 35

Pritësi që paguan një çek, i cili i kalon tjetrit me anë xhirimesh, duhet të verifikojë rradhën e rregullt të xhirimeve, por jo edhe nënshkrimet e xhiruesve.

Koment:

Banka nuk kontrollon nënshkrimet e të gjithë xhiruesve të çekut, por vetëm rregullshmërinë e rradhës së tyre.

Neni 36

Në rast se çeku është i pagueshëm në monedhë të huaj, shuma e tij do të paguhet brenda afatit të paraqitjes së monedhës shqiptare, sipas kursit të saj të këmbimit në ditën e pagimit.

Në qoftë se pagimi i çekut nuk është bërë me paraqitjen e tij, prurësi ka të drejtë, sipas pëlqimit të tij, të kërkojë që shuma t'i paguhet në monedhën e vendit sipas kursit të këmbimit të ditës së paraqitjes ose të pagimit.

Lëshuesi i çekut mund të caktojë që shuma për t'u paguar të llogaritet sipas kursit të treguar në çek.

Dispozitat e mësipërme nuk zbatohen në rast se lëshuesi ka caktuar që pagimi të bëhet në një monedhë shprehimisht të treguar (kushti i pagimit efektiv në monedhë të huaj), por, veprimet juridike mbi këtë monedhë duhet të bëhen gjithmonë në pajtim me dispozitat e veçanta mbi veprimet juridike në lidhje me arin dhe valutën e huaj.

Në qoftë se shuma e çekut është treguar në një monedhë që ka të njëjtin emër por një vleftë të ndryshme në vendin e lëshimit të çekut dhe në atë të pagimit, prezumohet se tregimi i referohet monedhës së vendit të pagimit.

Koment:

Në këtë nen përcaktohen dy raste :

1. Në qoftë se shuma e përcaktuar tek çeku është në valutë (dhe në qoftë se nuk është caktuar asgjë nga ana e lëshuesit) atëherë ky çek do të paguhet brenda afatit të paraqitjes në monedhën shqiptare, sipas kursit të këmbimit në ditën e pagimit.

2. Në qoftë se shuma e çekut është në valutë, atëherë lëshuesi i çekut mund të caktojë vetëm që shuma për t'u paguar të llogaritet sipas kursit të treguar në çek.

Pagimi në monedhën shqiptare nuk zbatohet, në rast se lëshuesi ka caktuar që pagimi të bëhet në një monedhë shprehimisht të caktuar, për shembull, është caktuar që më parë në çek që ky i fundit të paguhet në USD (\$) – (kushti i pagimit efektiv në monedhë të huaj).

KREU V

ÇEKU ME HEQJE VIJASH. ÇEKU PËR KALIM NË LLOGARI ÇEKU I UDHËTARIT. ÇEKU ME KLAUZOLËN “JO I TRANSFERUESHËM”.

Neni 37

Lëshuesi ose prurësi i çekut mund të heqë në faqen e parë të çekut dy vija paralele, me pasojat që tregohen në nenin e mëposhtëm.

Heqja e vijave mund të jetë e përgjithshme ose e veçantë.

Heqja e vijave është e përgjithshme kur midis dy vijave nuk është shënuar emri i ndonjë institucioni krediti dhe është e veçantë kur midis dy vijave është shënuar emri i një institucioni krediti të caktuar.

Shuarja e vijave ose e emrit të institucionit të kreditit quhet se nuk është bërë.

Neni 38

Çeku me heqje të vijave të përgjithshme mund t'i paguhet nga pritësi vetëm një

institucioni krediti ose një klienti të tij.

Çeku me heqje të vijave të veçanta mund ti paguhet nga pritësi vetëm institucionit të kreditit të shënuar në vijat dhe në qoftë se ky është pritësi, një klienti të tij.

Megjithatë ky institucion krediti (i shënuar në vijat) mund t'i shërbejë për arkëtim një institucioni tjetër krediti.

Një institucion krediti nuk mund të pranojë një çek me heqje vijash që jep një klient ose një institucion tjetër krediti. Nuk mund ta arkëtojë këtë çek për llogari të personave të tjerë, përveç atyre të lartpërmendur.

Një çek me heqje vijash të veçanta të ndryshme, nuk mund të paguhet nga pritësi, përveç rasteve kur kemi të bëjmë me dy heqje vijash, nga të cilat njëra shërben si mjet kompensimi.

Pritësi, që ka paguar çekun në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, është përgjegjës për dëmet e shkaktuara, por në masën që nuk e kalon shumën e çekut.

Koment i neneve 37 dhe 38 :

Vijat paralele mbi një çek, janë shenja konvencionale pengimi me qëllim të caktuar duke e detyruar poseduesin legjitim që t'a paraqitë për arkëtim çekun jo direkt pranë bankës emetuese, por nëpërmjet një banke tjetër. Vijat hiqen në faqen e sipërme të çekut, në formë paralele, me ose pa shënime.

Çeku me heqje vijash të përgjithshme mund të transformohet në çek me heqje vijash të veçantë, por nuk mund të ndodhë e kundërta. Në çeqet me heqje vijash të veçantë, fshirja e emrit midis vijave quhet se nuk është bërë.

Ndryshe nga çeku me klauzolën "jo i transferueshëm", heqja e vijave mbi çek nuk influencon në qarkullimin e çekut, i cili mund të jetë i transferueshëm edhe në të bardhë; kjo gjë jep garanci më të mëdha sesa në fazën e pagimit të çekut. Kështu, nëse çeku me heqje vijash humbet ose vidhet, kushdo që do të bëhet zotëruesi i tij, praktikisht, nuk ka mundësinë ta arkëtojë atë.

Në praktikë, heqja e vijave, i jep atij që i vendos, sigurinë që çeku do t'i paguhet një personi të besuar në sistemin bankar.

Neni 39

Lëshuesi ose prurësi i çekut mund të ndalojë pagimin e çekut me të holla në dorë

duke shënuar në faqen e parë të tij fjalën “vetëm për kalim në llogari” ose një shprehje tjetër të këtij lloji. Në këtë rast, pritësi duhet të paguajë çekun vetëm me anë kalimi në llogari. Në qoftë se në shënimin e bërë tregohet edhe llogaria, pritësi mund të kalojë shumën e çekut vetëm në llogarinë e treguar.

Tregimi i llogarisë mund të bëhet si nga lëshuesi, ashtu edhe nga prurësi.

Shuarja ose ndryshimi i shënimit “vetëm për kalim në llogari” ose i një shprehjeje tjetër të tillë, si dhe shuarja ose ndryshimi i tregimit të llogarisë quhen se nuk janë bërë.

Pritësi që ka paguar çekun në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, është përgjegjës për dëmet e shkaktuara, por gjithmonë në masën që nuk kalon shumën e çekut.

Koment:

Klauzola “vetëm për kalim në llogari” ka të njëjtin funksion si tek çeku me heqje vijash, mbrojtjen kundrejt rrezikut të falsifikimit. Heqja e kësaj klauzole nga mbajtësit e mëpasmë të çekut, quhet se nuk është bërë.

Banka pritëse është e detyruar të bëjë kreditimin e llogarisë së treguar në çek.

Neni 39/a

ÇEKU I UDHËTARIT

Kur një çek emetohet nga një bankë me kërkesën e një personi, i cili i ka paguar bankës emetuese shumën korresponduese, dhe çeku i sipërpërmendur i paguhet vetëm këtij personi, nën termat e vendosur si më poshtë, emërtohet “çek i udhëtarit”.

Termi “çek i udhëtarit” vendoset në trupin e këtij instrumenti.

Çeku i udhëtarit nënshkruhet nga personi i sipërpërmendur që në momentin e emetimit dhe është i pagueshëm vetëm ndaj tij, me kusht që ky i fundit të kundërfirmosë çekun e udhëtarit në momentin kur paraqet këtë çek për pagesë.

Çeku i udhëtarit nuk mund të xhirohet.

Çeku i udhëtarit është i pagueshëm me të parë brenda 12 muajve nga data e emetimit.

Neni 39/b

Në rast se çeku i udhëtarit humbet, vidhet ose dëmtohet, personi i sipërpërmendur duhet të lajmërojë menjëherë për sa më sipër bankën emetuese, e cila duhet t'i kthejë atij shumën e parave të çekut të udhëtarit në kohën e maturimit, sipas afatit të mësipërm 12 mujor, gjatë të cilit ky çek është i vlefshëm për pagesë.

Banka është e shkarkuar nga përgjegjësia në qoftë se çeku i udhëtarit është paguar nga ajo me mirëbesim, përpara njoftimit të parashikuar sa më sipër.

Koment i neneve 39/a dhe 39/b:

Çeku i udhëtarit është një kategori speciale çeqesh, të lëshuar nga çdo bankë mbi veten e saj dhe të pagueshëm nga të gjitha bankat e tjera korrespondente. Ai emetohet me kërkesën e personit të interesuar, në modularë të posaçëm dhe me prerje të ndryshme, të lidhura në blloqe me dy pjesë që përmbajnë numër dhe seri të njëjtë në secilën pjesë. Firma e parë vendoset në momentin e emetimit të çekut, ndërsa firma e dytë (kundërfirma) e personit vihet në vendin e posaçëm të rezervuar për këtë qëllim në prezencë të nëpunësit të bankës që kryen pagesën, ose të shitësit të mallit që paguhet dhe që pranon çekun, njëlloj siç ka nënshkruar në kohën e blerjes së çekut. Xhirimi në shpinë të çekut është i panevojshëm. Çeku i udhëtarit ka vetinë të jetë i cedueshëm, duke vënë në vendin e caktuar emrin e atij që dëshirohet t'i jepet. Në këtë rast, përfituesi bën arkëtimin me anë të xhirit. Në rast humbjeje të këtij lloj çeku ose blloku çeqesh lajmërohet, me mjetet më të shpejta të mundshme, banka emetuese e tyre, e cila menjëherë njofton bankat korrespondente për pavlefshmërinë e çeqeve të humbura. Hedhja e firmës së dytë në prezencë të nëpunësit të bankës, ose shitësit ndërsa kryen aktin e xhirit, bën që të sigurohet pamundësia e përvetësimit të tij nga vjedhësit apo, nga ata që mund ta kenë gjetur në rast humbjeje.

Neni 39/c

Klauzola “jo i transferueshëm”.

Çeku i emetuar me klauzolën “jo i transferueshëm” i paguhet vetëm prurësit ose, sipas kërkesës së tij, i kreditohet në llogarinë e tij bankare. Prurësi xhiron çekun në fjalë vetëm tek një bankë për thyerje dhe banka nuk e xhiron atë më tej. Xhirimet e bëra duke mos respektuar kërkesat sa më sipër, nuk merren parasysh si të qëna.

Fshirja (shuarja) e klauzolës “jo i transferueshëm” quhet e pavlefshme. Pritësi i cili paguan një çek me klauzolën “jo i transferueshëm” një personi tjetër, përveç përfituesit të duhur ose bankierit për thyerje, mbetet i detyruar t’i paguajë përsëri shumën e çekut përfituesit të duhur dhe është përgjegjës për dëmet që i ka shkaktuar lëshuesit, me përjashtim të rasteve kur pritësi e ka kryer pagesën ndaj një personi tjetër, që nuk është përfituesi i duhur (prurësi) duke qënë i mashtruar dhe jo si rezultat i sjelljes së tij neglizhente.

Klauzola “jo i transferueshëm” mund të futet prej një xhiruesi dhe ka të njëjtat efekte si më sipër.

Neni 39/ç

Në qoftë se një çek me klauzolën “jo i transferueshëm” humbet, vidhet ose dëmtohet, procedura e amortizimit nuk zbatohet dhe pritësi i paguan prurësit (përfituesi i ligjshëm) sasinë e çekut pas 30 ditëve nga njoftimi që ky i fundit u bën lëshuesit dhe pritësit për humbjen, për vjedhjen ose për dëmtimin e çekut. Por, kjo ndodh nëse lëshuesi nuk njofton pritësin dhe prurësin se ai është kundër kësaj pagese, pra provon se çeku, i cili duhet të paguhet, nuk është lëshuar në interes të prurësit.

Koment i neneve 39/c dhe 39/ç:

Nëse mbi çek vihet klauzola “jo i transferueshëm”, kjo do të thotë se banka emetuese do t’ia paguajë shumën vetëm përfituesit të treguar në çek, pra, në këtë rast ai nuk mundet që t’ja kalojë tjetërkujt të drejtën e vet me anë të xhirit.

Klauzola “jo i transferueshëm” ka funksionin të mbrojtë poseduesin e çekut kundrejt rreziqeve që vijnë si pasojë e humbjes apo e vjedhjes së çekut. Një klauzolë e tillë e kthen çekun të pagueshëm në një llogari rrjedhëse vetëm për prurësin (përfituesin), nëse klauzola është vendosur nga lëshuesi i çekut, ose nëse ajo është vendosur nga një xhirues, për përfituesin e mëpasëm.

Klauzola “jo i transferueshëm” ka efektin të përjashtojë çdo xhirim të mëtejshëm të

çekut, madje edhe një kalim të thjeshtë të tij.

Ndryshimin ndërmjet çekut “jo në urdhër” dhe çekut “jo i transferueshëm” e shohim në faktin që çeku “jo në urdhër” është i konceptuar si i tillë sipas përcaktimit të bërë në nenin 5 të ligjit, ndërsa çeku që i vihet shënimi “jo i transferueshëm” konvertohet në një çek “jo në urdhër”.

KREU VI

E DREJTA E KTHIMIT PËR MUNGESË PAGIMI TË ÇEKUT

Neni 40

Prurësi i çekut ka të drejtë të kërkojë nga xhiruesi, lëshuesi dhe nga të detyruarit e tjerë kthimin e shumës së çekut të paguar (e drejta e kthimit), në qoftë se çeku është paraqitur për pagim në afatin e duhur dhe nuk është paguar nga pritësi.

Paraqitja e çekut për pagim dhe mospagimi i tij duhet të vërtetohet:

a) me akt-noterial (protestë) ; ose

b) me deklaratë të pritësit të shkruar mbi çek, me tregimin e vendit dhe të ditës së paraqitjes, ose

c) me deklaratë të një institucioni që ka të drejtë të bëjë kompensimin reciprok të pagesave, me datë dhe me shënim në çek se ky është paraqitur në këtë institucion brenda afatit të caktuar, por nuk është paguar.

Koment:

Përfituesi i çekut ka të drejtë të kërkojë të paguhet për të njëjtën shumë që çeku është lëshuar, nëse me anë të çekut nuk e ka përfituar atë. Ai e kërkon shumën për t'u paguar si nga lëshuesi , xhiruesi apo të detyruarit e tjerë. Të detyruarit e tjerë mund të jenë avaluesi, xhirues të tjerë. Mjetet për kërkimin e shumës për t'u paguar janë:

a) Akti noterial.

b) Banka që ka kthyer çekun të papaguar tregon dhe arsyen për mospagimin e çekut, të shoqëruar me vulën përkatëse që tregon vendin dhe datën kur u konstatua një gjë e tillë.

c) Deklaratën e Zyrës së kleringut. Tek ne një deklaram i tillë mund të merret për çequet në tërësi, pasi kjo zyrë nuk procedon çequet një për një, por në grup pra nuk ka mundësi njohjeje për çekun në vecanti.

Neni 40/a

Prurësi i çekut ka të drejtat e tij kundrejt lëshuesit të çekut, megjithëse çeku nuk është paraqitur në kohën e duhur, ose nuk është bërë protesta a konstatimi ekuivalent. Në qoftë se pas kalimit të afatit të paraqitjes së çekut, disponimi i shumës nuk ekziston jo për faj të lëshuesit të çekut, prurësi i çekut humbet të drejtat e tilla në një pjesë ose në të gjithë shumën që mungon.

Koment:

Përfituesi ka të drejtë, gjithashtu, të kërkojë pagimin e shumës së treguar në çek megjithëse nuk e ka paraqitur atë brenda afatit, por nëse në këtë moment, lëshuesi nuk ka gjëndje në llogari, jo për faj të tij (per shembull banka ka falimentuar!!), ai humbet të drejtën kundrejt çekut.

Neni 41

Protesta ose konstatimi që ka të njëjtën vleftë duhet të bëhet para se të ketë mbaruar afati i paraqitjes.

Në qoftë se paraqitja e çekut është bërë ditën e fundit të afatit, protesta ose konstatimi që ka të njëjtën vleftë mund të bëhet ditën e parë të punës që vjen pas asaj.

Koment:

Protesta është akti që provon mospranimin ose mospagimin e një çeku në paraqitjen e tij për pagim. Protesta mund të kryhet për mospranim, për mospagim ose edhe për pranim ose pagim jo të plotë, për pjesën e papranuar ose të papaguar.

Protesta për mospagimin e çekut duhet të bëhet para përfundimit të afatit të paraqitjes, ç'ka nënkupton që çeku të jetë prezantuar në bankë brenda këtij afati dhe përfituesi të ketë marrë njoftimin për mospagimin e çekut.

Për të ushtruar të drejtën e kthimit, protesta duhet të bëhet brenda kohës së paraqitjes së çekut për pagim.

Neni 42

Prurësi duhet të lajmërojë xhiruesin e tij dhe lëshuesin e çekut për mospagimin e çekut brenda katër ditëve punë që vijnë pas protestës ose konstatimit që ka të njëjtën vleftë, dhe në qoftë se është vënë kushti “pa shpenzime”, po ditën e paraqitjes. Çdo xhirues, në të dy ditët e punës që vijnë pas ditës në të cilën ka

marrë lajmërimin, duhet të njoftojë xhiruesin e mëparshëm për lajmërimin që mori, duke treguar emrat dhe adresat e atyre që kanë dhënë lajmërimet e mëparshme, dhe duke vazhduar kështu të arrijë gjer të lëshuesi i çekut. Afatet e përmendura fillojnë të ecin nga marrja e lajmërimit të mëparshëm.

Në qoftë se, në pajtim me paragrafin e mëparshëm, lajmërimi i është bërë një nënshkruesi të çekut, një lajmërim i tillë duhet bërë, brenda të njëjtit afat, avaluesit të tij.

Në qoftë se një xhirues nuk ka treguar adresën e tij ose e ka treguar këtë në mënyrë të palexueshme, mjafton që lajmërimi t'i bëhet xhiruesit që është para tij. Kushdo që është detyruar të bëjë lajmërimin, mund ta bëjë në çdo formë dhe me dërgimin e thjeshtë të çekut. Ai duhet të provojë se ka bërë lajmërimin në afatin e caktuar. Quket se lajmërimi është në afat, kur është bërë me letër që është dërguar në postë në afatin e përmendur. Ai që nuk bën lajmërimin në afatin e përmendur më sipër, nuk humbet të drejtën e tij me dekadencë, megjithatë, është përgjegjës për pakujdesinë e tij në qoftë se ka shkaktuar dëm, por pa e kaluar masa e shpërblimit shumë e çekut.

Koment:

Në rastet kur çeku nuk është paguar nga pritësi dhe prurësi ka bërë protestë për mospagim çeku, për këtë protestë ai (prurësi), duhet të lajmërojë xhiruesin dhe lëshuesin e çekut, brenda një periudhe prej 4 ditësh punë që vijnë pas ditës që është bërë protesta në organet kompetente.

Çdo xhirues i fundit duhet të bëjë lajmërimin tek xhiruesi i mëparshëm për lajmërimin që ai mori, duke vazhduar deri tek lëshuesi i çekut. Kjo periudhë duhet të jetë brenda dy ditësh.

Në paragrafin e dytë bëhet fjalë kur është bërë lajmërimi një nënshkruesi të çekut, për shembull një xhiruesi, atëherë duhet bërë dhe lajmërimi i avaluesit, domethënë, atij që ka bërë garantimin e këtij çeku, në qoftë se ekziston.

Neni 43

Lëshuesi i çekut, xhiruesi ose avaluesi mund të shkarkojë prurësin nga detyrimi i protestës, ose nga ai i një deklarimi që ka të njëjtën vlefë për të ushtruar të drejtën e kthimit, duke vënë në dokument shënimin “pa shpenzime” ose “pa protestë”, ose çdo tjetër fjalë që ka të njëjtën vlerë.

Ky shënim nuk shkarkon prurësin nga detyrimi i paraqitjes së çekut, në afatet e caktuara, as nga ai i lajmërimeve.

Prova që nuk janë mbajtur afatet në këto veprime i bie atij që j'a kundërshton prurësit.

Në rast se shënimi është vënë nga lëshuesi i çekut, ai ka efekt kundrejt të gjithë nënshkruesve, kurse në rast se është vënë nga një xhirues ose nga avaluesi ka efekt vetëm kundrejt këtij.

Kur shënimi është vënë nga lëshuesi i çekut dhe prurësi bën protestën ose një konstatim që ka të njëjtën vleftë, shpenzimet mbeten në ngarkim të tij. Kur shënimi është vënë nga një xhirues ose nga një avalues, shpenzimet e protestës ose të konstatimit që ka të njëjtën vleftë, në rast se njëri nga këto veprime është bërë, janë të kërkueshëm nga të gjithë nënshkruesit.

Koment:

Shënimi "pa shpenzime", "pa protestë" synon heqjen e ushtrimit të së drejtës së kthimit. Prurësi i çekut duhet ta paraqesë atë njëlloj në bankë brenda afateve. Neni bën dallimin nëse shënimi është vendosur nga lëshuesi i çekut apo nga xhiruesi apo avaluesi i tij.

Paragrafi i dytë dhe paragrafi i tretë duket sikur kundërshtojnë njëri-tjetrin.

Neni 44

Të gjithë personat që janë të detyruar në bazë të çekut përgjigjen solidarisht kundrejt prurësit.

Prurësi ka të drejtë të ngrejë padi kundër të gjithë atyre që kanë nënshkruar çekun si kundër cilido prej tyre individualisht ashtu edhe kundër atyre bashkarisht dhe nuk është i detyruar t'i mbahet rradhës në të cilën këta kanë marrë detyrimin.

Të njëjtën të drejtë e ka dhe cilido nënshkrues që ka paguar çekun.

Padia e ngritur kundër njërit nga të detyruarit nuk ndalon që të ngrihet padia dhe kundër të detyruarve të tjerë, edhe kur këta janë të mëpasme nga ai kundër të cilit u ngrit më parë padia.

Koment:

Në këtë nen jepet një përcaktim i përgjithshëm lidhur me detyrimin solidar që ekziston ndërmjet xhiruesve dhe atyre që kanë nënshkruar çekun, kundrejt prurësit të tij (ky është detyrimi solidar ndërmjet palëve që nënshkruajnë çekun).

Efektet e veçanta që lindin në detyrimin solidar, gjejnë trajtim në dispozitat përkatëse të Kodit Civil lidhur me përgjegjësinë solidare ndërmjet palëve dhe të drejtën e regresit ose të drejtën e kthimit, që nuk është gjë tjetër veçse e drejta që i takon debitorit solidar në rastin e pagimit të detyrimit në total për të gjithë bashkëdebitorët e tjerë, për të kërkuar kthimin e pjesëve përkatëse që ai ka paguar për llogari të tyre.

E njëjta gjë nënvizohet edhe në nenin 48/a.

Neni 45

Prurësi mund të kërkojë nga ai kundër të cilit ushtron të drejtën e kthimit:

- a) shumën e çekut të papaguar;**
- b) kamatën e llogaritur në bazë të interesave debitore të depozitave të bankës ku ka llogarinë e tij, duke filluar nga dita kur çeku paraqitet për arkëtim dhe deri në ditën e arkëtimit;**
- c) shpenzimet për protestën ose konstatimin që ka të njëjtën vleftë, ato për lajmërimet e tjera, si dhe shpenzimet e tjera.**

Koment:

Kërkesa e përfituesit për një nga elementët e përmendura në këtë nen mund të realizohet nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së kthimit të çekut kundrejt lëshuesit, xhiruesit.

Neni 46

Ai që ka paguar çekun mund të kërkojë nga ata që janë të detyruar kundrejt tij:

- a) të gjithë shumën që ka paguar;**
- b) kamatën e llogaritur mbi interesat debitore, duke filluar nga dita që ai ka paguar çekun deri në ditën kur kthehet shuma e çekut të paguar;**
- c) shpenzimet që ka bërë.**

Koment:

Nga ana tjetër, lëshuesi (xhiruesi), personi që ka paguar çekun kërkon një nga elementët e përmendura në nenin 46 prej çdonjërit nga personat e detyruar, kur reklamohet çeku sipas neneve më lart të këtij kreu.

Neni 47

Kushdo që është i detyruar në bazë të çekut dhe kundër të cilit është ushtruar ose mund të ushtrohet e drejta e kthimit, ka të drejtë të kërkojë në kohën e pagimit, kundër pagesës dorëzimit të çekut bashkë me protestën ose konstatimin që ka të njëjtën vleftë dhe llogarinë e shlyer.

Cilido xhirues që ka paguar çekun mund të shuajë xhirimin e tij dhe ato të xhiruesve të mëpasme.

Koment:

Në momentin që çeku paguhet, nuk ka kuptim më të flitet për xhirim të çekut, dhe nuk kanë më rëndësi xhirimet paraardhëse (të cilat janë nul). Xhirime pasardhëse nuk mund të bëhen më pas pagimit të çekut.

Neni 48

Kur një pengesë e pakapërcyeshme (dispozitë ligjore e një shteti ose rast tjetër force madhore) ndalon që, brenda afateve të caktuara të paraqitet çeku, të bëhet protesta ose të merret konstatimi që ka të njëjtën vleftë, afatet zgjatën.

Prurësi detyrohet që të lajmërojë pa vonesë për rastin e forcës madhore xhiruesin e mëparshëm dhe të bëjë fjalë për këtë lajmërim me një shënim që do të këtë datë dhe do të jetë nënshkruar prej tij mbi çekun ose mbi zgjatjen; për të tjerat zbatohen dispozitat e nenit 42.

Kur forca madhore ka pushuar, prurësi duhet të paraqitë pa vonesë çekun për pagesë dhe në rast se është e nevojshme, të bëjë protestë ose të marrë një konstatim, që ka të njëjtën vleftë.

Në rast se forca madhore vazhdon më tepër se 15 ditë nga dita në të cilën prurësi lajmëroi xhiruesin e mëparshëm për forcën madhore, edhe kur ky lajmërim është bërë para mbarimit të afatit të paraqitjes, e drejta e kthimit mund të ushtrohet pa qënë e nevojshme që të bëhet paraqitja, protesta ose konstatimi që ka të njëjtën vleftë.

Nuk quhen raste forcë madhore faktet që janë thjeshtësisht personale për prurësin ose për personin e ngarkuar për të paraqitur çekun për të bërë protestë, ose për të patur një konstatim që ka të njëjtën vleftë.

Koment:

Afatet për paraqitjen për pagim të çekut ose për bërjen e protestës mund të shtyhen, nëse krijohet ndonjë nga rrethanat e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni. Për këtë, prurësi njofton xhiruesin e mëparshëm me një shënim që e vë mbi çek ose në pjesën zgjatuese të tij, me datën konkrete. Si rregull, me mbarimin e rrethanave të parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni (forca madhore etj.), prurësi duhet ta paraqesë çekun për pagesë, të bëjë protestën a konstatimin, sipas rastit. Në rast se forca madhore vazhdon për më tepër se 15 ditë, nga dita në të cilën prurësi ka lajmëruar xhiruesin e mëparshëm për forcën madhore, mund të ushtrohet e drejta e kthimit pa qenë e nevojshme të bëhet paraqitja e çekut ose protesta a konstatimi, sipas rastit.

Neni 48/a

Midis detyruesve që kanë të njëjtin detyrim në lidhje me çekun, nuk vepron ndonjë dispozitë mbi çekun, dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre rregullohen nga dispozitat e Kodit Civil mbi detyrimet solidare dhe të veçanta për çdo detyrues.

Koment:

Për të rregulluar raportet e të deturuarve solidare (që kanë të njëjtin detyrim në lidhje me çekun), zbatohen dispozitat e Kodit Civil për detyrimet solidare për çdo detyrues (nenet 423 deri 435).

Neni 48/b

Çeku ka efektin e një titulli ekzekutiv në lidhje me shumën bazë të tij, interesin dhe shpenzimet, në përputhje me nenet 45 dhe 46 të dekretit për çekun. Përveç rasteve kur kemi arsye të bazuara dhe shumë serioze, ekzekutimi i mëtejshëm mbi çekun nuk pezullohet.

Koment:

Mbështetur në nenin 510 gërma (dh) të Kodit të Procedurës Civile, çeku është titull ekzekutiv, ç'ka nënkupton ekzekutimin e detyrueshëm të tij. Për çekun, shumën e tij, interesin dhe shpenzimet e tjera sipas këtij dekreti, do të zbatohen dispozitat e Kodit të

Procedurës Civile në lidhje me titujt ekzekutivë.

Neni 48/c

Në çdo procedurë gjyqësore të bazuar në veprimet mbi çekun, debitori mund të ngrejë vetëm përjashtimet për pavlefshmërinë e çekut në përputhje me dispozitat ligjore për çekun.

Në rastin e përjashtimeve të ngritura nga debitori, nga ku kërkohet një hetim i gjatë, gjykata, mbi bazën e kërkesës së kreditorit, nxjerr një vendim gjyqësor (urdhër) të përkohshëm për pagesën kundër debitorit, ndërsa procedura gjyqësore mbetet pezull dhe sipas gjykimit të gjykatës kërkohet që kreditori të vendosë një depozite garancie.

Koment:

Çeku mund të konsiderohet i pavlefshëm vetëm në lidhje me dispozitat e këtij dekreti dhe përsa parashikon ky dekret.

Në rastet e një procedure gjyqësore, për pretendimet e ngritura nga kreditori, gjykata, me një vendim të ndërmjetëm, mund të detyrojë debitorin për t'i paguar shumën mbi bazën e çekut kreditorit, ndërkohë që, sipas gjykimit të saj, mund të detyrojë kreditorin për të vendosur një depozitë garancie për të njëjtën shumë, deri në përfundimin e procesit gjyqësor.

Neni 48/ç

Çeku është një instrument pagese i pavarur, që rregullohet nga marrëdhëniet juridike mbi bazën e të cilave ai është emetuar ose xhiruar.

Çdo veprim që rrjedh nga marrëdhëniet e mësipërme juridike, mbetet, pavarësisht nga emetimi ose xhirimi i çekut, për deri sa nuk është provuar se ka ndodhur një ndryshim.

Mbajtësi i çekut nuk mund të ushtrojë të drejtën e ankimit, nëse nuk ofron rikthimin e çekut te debitori dhe nuk e depoziton ankesën në gjykatë. Gjithashtu, ai duhet të parashikojë më tej që formalitetet e nevojshme të jenë bërë në mënyrë të tillë që të kenë lejuar kryerjen e veprimeve të debitorit për ankesë në gjykatë.

Koment:

Çeku, si instrument (mjet) pagese, rregullohet nga marrëdhëniet juridike që e

përkufizojnë atë, nga ky dekret, nga Kodi Civil dhe Kodi i Procedurës Civile dhe nga dispozita të tjera ligjore konkrete. Këto marrëdhënie juridike mund të ndryshojnë vetëm nëse ndryshon baza ligjore mbi të cilën ajo mbështetet, dhe për rrjedhojë ndryshon edhe statusi i çekut, pavarësisht nga momenti i emetimit ose i xhirimit të tij.

Procedurat ankimore dhe gjyqësore janë të parashikuara, gjithashtu, në këtë bazë ligjore që përcakton këtë marrëdhënie juridike (mbi çekun).

Neni 48/d

Kur prurësi humbet të drejtën e kthimit kundrejt të gjithë detyruesve dhe nuk ngre kundrejt tyre padi, mund të ngrëjë padi kundër lëshuesit që nuk ka bërë rezervimin e fondeve ose që është pasuruar pa të drejtë në dëm të prurësit.

E njëjta padi mund të ushtrohet në kushtet e mësipërme dhe kundër xhiruesve.

Koment:

Prurësi i çekut mund të ngrerë padi kundër lëshuesit të çekut, për mungesë të fondeve, ose për begatim pa shkak të lëshuesit në dëm të prurësit, edhe kur ai e ka humbur ushtrimin e të drejtës së kthimit apo të ngritjes së padisë, kundrejt të gjithë të detyruarve në bazë të çekut.

KREU VII

EKZEMPLARËT E SHUMTË

Neni 49

Me përjashtim të çeqeve të prurësit, çdo çek tjetër, i lëshuar në një vend dhe i pagueshëm në një vend tjetër ose që është lëshuar dhe është i pagueshëm në të njëjtën pjesë ose në pjesë të ndryshme po të atij vendi, mund të lëshohet në shumë ekzemplarë (dublikate). Në qoftë se çeku është lëshuar në shumë ekzemplarë, këto duhet të përmbajnë në tekstin e tyre shënimin “i pari”, “i dyti”, etj. përndryshe çdo ekzemplar quhet si çek i veçantë.

Neni 50

Pagimi i njërit nga ekzemplarët shkarkon paguesin edhe sikur të mos jetë deklaruar se ky pagim e bën të pavlefshme fuqinë e ekzemplarëve të tjerë.

Xhiruesi që u ka kaluar ekzemplarët e personave të ndryshëm, si dhe xhiruesit e mëpasmë mbeten të detyruar për të gjithë ekzemplarët që mbajnë nënshkrimin e tyre dhe që nuk janë kthyer.

Koment për nenet 49 dhe 50:

Praktika nuk pranon një emetim të tillë të çeqeve, për shkak të rrezikut që mbart.

KREU VIII

NDRYSHIMET NË ÇEK

Neni 51

Në rast se teksti i çekut është ndryshuar, personi që ka vënë nënshkrimin e tij pas ndryshimit përgjigjet për tekstin e ndryshuar, ai që ka vënë nënshkrimin më parë përgjigjet sipas përmbajtjes së tekstit origjinal.

KREU IX

PARASHKRIMI

Neni 52

Paditë që rrjedhin nga e drejta e kthimit kundër xhiruesve, lëshuesit të çekut dhe kundër të detyruarve të tjerë parashkruhen me kalimin e 6 muajve nga mbarimi i afatit të paraqitjes së çekut.

Paditë që rrjedhin nga e drejta e kthimit, midis të detyruarve të ndryshëm në pagimin e çekut të njërit kundër të tjerëve, parashkruhen me kalimin e 6 muajve nga dita që i detyruari pagoi çekun ose nga dita që padia, e cila rrjedh nga e drejta e kthimit, ka qënë ngritur kundër tij.

Neni 53

Ndërprerja e parashkrimit ka efekt vetëm kundër atij ndaj të cilit u kthye veprimi që ndërpret parashkrimin.

Koment i neneve 52 dhe 53:

E drejta e kthimit ose siç njihet ndryshe e drejta e regresit, është e drejta që i takon debitorit solidar në rastin e pagimit të detyrimit në total, për të gjithë bashkëdebitorët e tjerë për të kërkuar kthimin e pjesëve përkatëse që ai ka paguar për llogari të tyre. E drejta e kthimit ose regresit, parashikohet në nenin 430 të Kodit Civil. E drejta e kthimit ose regresit, nënkupton edhe të drejtën e debitorit për të ngritur padinë e regresit, me anë të së cilës mund të kërkohej, si rregull, pagimi i shumës në pjesë të barabarta.

Koncepti i parashkrimit të padisë ka të bëjë me shuarjen e të drejtës së padisë, e cila nuk është ushtruar brenda afatit të caktuar në ligj (në rastin tonë 6 muaj). Pas kalimit të këtij afati, e drejta e padisë shuhet dhe nuk mund të realizohet me anë të gjykatës ose të një organi tjetër kompetent (neni 112 dhe në vazhdim, i Kodit Civil).

KREU X

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 54

Në kuptimin e institucionit të kreditit, të parashikuar nga dekreti “Për çekun”, përfshihen Banka e Shqipërisë, bankat e nivelit të dytë, institutet e sigurimeve shoqërore e shtetërore, si dhe çdo institucion tjetër financiar, që me ligj do të njehsohet me institucionin e kreditit.

Koment:

Ky përkufizim i dhënë nga ky nen, për “institucionin e kreditit”, ka këtë kuptim vetëm për dispozitat e këtij ligji.

Neni 55

Paraqitja dhe protesta e çekut duhet të bëhen vetëm në një ditë pune.

Kur dita e fundit e afatit të caktuar për të kryer veprime në lidhje me çekun dhe posaçërisht për të paraqitur çekun për të bërë protestë, ose për të patur një konstatim që ka të njëjtën vlefë, bie në një ditë pushimi, afati zgjatet deri në ditën e punës që vjen pas asaj të pushimit. Ditët e pushimit që janë në mes të afatit përfshihen në llogaritjen e afatit.

Neni 56

Në afatet e caktuara nuk llogaritet dita nga e cila duhet të fillojë afati.

Koment:

Llogaritja e afateve, në kuptim të këtij ligji, fillon të nesërmen e ditës në të cilën duhet të fillonte afati. Për shembull, në rastin e çeqeve personale, të paraqitura, në klering, afati fillon ditën e nesërme pas seancës së klerimit.

Neni 57

Nuk lejohet asnjë afat mëshire, as ligjore as gjyqësore.

Neni 58

Protesta e çekut bëhet me vërtetimin nga ana e zyrës së noterisë për paraqitjen e çekut për pagim dhe për mospagimin e tij. Ky vërtetim bëhet me një shënim mbi çekun, ose mbi zgjatjen, se çeku nuk është paguar.

Për vërtetimin e mospagimit të çekut bëhet shënim dhe në regjistrin e zyrës së noterisë.

Koment:

I rëndësishëm në këtë nen është momenti i berjes së protestës për mospagimin e çekut, vetëm para noterit. Noteri bën shënimet në regjistrin e zyrës së noterisë dhe lëshon vërtetimin përkatës me shënimin mbi çek ose në pjesën zgjatuese të tij.

Neni 59 - SHFUQIZUAR

Kur një çek ka humbur është vjedhur ose është prishur, prurësi i tij ka të drejtë të lajmërojë pritësin që të mos paguajë çekun dhe të kërkojë nga gjykata popullore e vendit të pagimit, zhvleftësimin e çekut, sipas dispozitave mbi zhvleftësimin e letrave me vlerë, të parashikuar nga nenet 349-357 të Kodit të Procedurës Civile.

KREU X/1

“AMORTIZIMI”

Neni 59/a

Në rast humbjeje, vjedhjeje ose dëmtimi të çekut, mbajtësi i fundit njofton me shkrim pritësin, për ngjarjen e ndodhur, si dhe bën deklarimin në gjykatë lidhur me amortizimin e çekut.

Deklarata e bërë përmban elementët e prirura për identifikimin e çekut dhe një përshkrim të fakteve që kanë çuar në shkakun e humbjes, të vjedhjes ose të dëmtimit të çekut përkatës.

Neni 59/b

Gjykata pasi shqyrton faktet e duhura për të drejtën e mbajtësit të çekut, i deklaron me vendim të shpallur mbajtësit të fundit dhe lëshuesit të çekut amortizimin e çekut përkatës, duke autorizuar pritësin të kryejë, pagimin e çekut, 15 ditë nga dita e shpalljes së vendimit të saj.

Pritësi nuk është përgjegjës për pagesën e një çeku të bërë përpara se të marrë njoftimin për aktin e amortizimit.

Neni 59/c

Gjatë afatit të sipërpërmendur, mbajtësi aktual i çekut ngre një kundërshtim në gjykatë dhe njofton për këtë lëshuesin, pritësin dhe personin që ka kërkuar amortizimin, me qëllim që të provojë se e ka fituar me të drejtë çekun pa mashtrim ose neglizhencë.

Pasi afati 15 ditor të ketë kaluar pa ndonjë kundërshtim të ngritur në gjykatë ose në qoftë se kundërshtimi i ngritur ka qënë refuzuar nga gjykata, çeku i amortizuar bëhet i paefektshëm dhe, ai që ka përpiluar kërkesën për amortizim, fiton shumën e pagesës së çekut kundrejt paraqitjes së aktit të amortizimit dhe vendimit të shpallur nga gjykata, e cila vlerëson mosekzistencën ose refuzimin e ndonjë kundërshtimi të ngritur.

Në ndonjë rast, gjithnjë pas amortizimit, mbajtësi aktual ruan të drejtën e tij, në qoftë se e ka, kundër personit në favor të të cilit ka qënë deklaruar amortizimi.

Koment për nenet 59/a, 59/b, 59/c:

Akti i amortizimit të çekut, i përpiluar nga mbajtësi i fundit i çekut, përdoret në rastet kur çeku ka humbur, është vjedhur, dëmtuar apo grisur. Procedura për këtë shkak shprehet në nenet më lart. Deklarimi në gjykatë, i cili përmban të dhënat mbi çekun e humbur dhe rrethanat në të cilat ndodhi amortizimi i çekut, përbëjnë bazën për gjykimin e çështjes nga gjykata dhe shpalljen e çekut të amortizuar. Afati 15 ditor është i vlefshëm që mbajtësi aktual i çekut, personi që e ka gjetur çekun të themi pa dëmtuar njeri, të bëjë kundërshtim në gjykatë, duke dashur të provojë se e ka fituar çekun pa abuzuar mbi ndonjë palë, kështu ai njofton të gjitha palët; lëshuesin e çekut, pritësin, “të dëmtuarin”, atë që i ka humbur çekun.

Neni 60

Kundër të detyruarve në bazë të çekut, çeku i lëshuar brenda shtetit është titull ekzekutiv, sipas dispozitave të nenit 365 germa “g” të Kodit të Procedurës Civile për shumën që tregohet në te, për kamatën dhe për shpenzimet e bëra, pasi të jetë vërtetuar mospagimi sipas nenit 40 të këtij dekreti.

Koment:

Titull ekzekutiv është ekzekutimi i detyrueshëm i urdhrit. Referimi për çekun si titull ekzekutiv është në nenin 510 të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 61

Kur për pagimin e një detyrimi është dorëzuar në vend të të hollave një çek, detyrimi quhet i shuar vetëm nga çasti i pagimit të çekut, përveç kur palët janë marrë vesh midis tyre ndryshe.

Koment:

Kur merret një çek bankar për pagimin e një detyrimi, detyrimi është i shlyer në moment.

Kur një çek jo i garantuar, jobankar merret për pagimin e një detyrimi, detyrimi është pezull deri sa çeku të paguhet ose të garantohet. Në një rast të tillë detyrimi është i pashlyer ose i papaguar.

Neni 62

Në rast se prurësi ka humbur padinë që rrjedh nga çeku kundër të gjithë të detyruarve, ai mund të ngrejë kundër lëshuesit të çekut ose kundër xhiruesve

padi për begatim pa shkak.

Kjo padi parashkruhet me kalimin e tre vjetëve nga dita që pritësi nuk ka pranuar të paguajë çekun.

Koment:

Padia për begatimin pa shkak parashikohet nga neni 658 i Kodit Civil. Padia për begatim pa shkak ngrihet vetëm atëherë, kur personi i interesuar nuk mund të mbrohet me paditë që rrjedhin nga kontrata, me padinë e rivendikimit, me padinë për shpërblim dëmi ose me padi të tjera për mbrojtjen e pronësisë.

Sipas nenit 655 të Kodit Civil, begatim pa shkak kemi atëherë kur personi që pa një shkak të ligjshëm ka fituar ose ka kursyer diçka në dëm të një personi tjetër, dhe detyrohet të shpërblejë këtë të fundit për humbjet pasurore që ka pësuar, brenda caqeve të begatimit.

KREU X/2

SANKSIONET

Neni 62/a

Ai që lëshon një çek pa autorizimin paraprak të pritësit ose pasi autorizimi anulohet, dënohet me heqje lirie nga 3 muaj deri në 1 vit.

Neni 62/b

Ai që lëshon një çek, i cili është paraqitur për pagesë brenda afatit të parashikuar nga ky ligj, por nuk është paguar i plotë ose pjesërisht për mungesë fondesh, gjobitet me 12 për qind të sasisë së çekut.

Gjithashtu, ai është i detyruar t'i paguajë mbajtësit legjitim të çekut, i cili ka ngritur padi ndaj tij, një gjobë të barabartë me 10 për qind të sasisë së mospaguar, së bashku me interesat e akumuluar.

Gjoha, e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, nuk zbatohet nëse brenda 80 ditëve nga mbarimi i afatit të paraqitjes së çekut për pagesë lëshuesi paguan çekun me interesat përkatës dhe shumën e gjobës të parashikuar në paragrafin e dytë të këtij neni, si dhe një kuotë për protestën ose për deklarimin ekuivalent me të.

Pagesa mund të kryhet drejtpërsëdrejti në favor të mbajtësit të çekut ose tek pritësi në interes të mbajtësit të çekut.

Neni 62/c

Nëse ndonjë person është dënuar sipas nenit 62/a ose është gjobitur sipas nenit 62/b, ai nuk ka të drejtë të tërheqë asnjë lloj çeku gjatë afatit kohor nga 6 muaj deri në 2 vjet.

Nëse vepron ndryshe dënohet me heqje lirie nga 2 deri në 6 muaj.

Neni 62/ç

Ai që lëshon një çek pa shënuar datën kur çeku është lëshuar ose e lëshon atë me një datë të falsifikuar, gjobitet me 2 për qind të sasisë së çekut.

Neni 62/d

Kur një çek nuk paguhet i plotë ose pjesërisht për mungesë fondesh dhe si rrjedhim i kësaj është përdorur protesta ose deklarimi i njëjtë me të, pritësi me një njoftim të thjeshtë, të dërguar me telegram ose me mjete të tjera të këtij lloji ia anulon lëshuesit autorizimin për të tërhequr ndonjë çek, duke i kërkuar kthimin e çdo forme çeku që është në pronësi të tij.

Neni 62/dh

Përpara afatit të paktën tre mujor që nga koha e marrjes të njoftimit sipas nenit 62/d të këtij ligji, nuk mund të jepet asnjë autorizim tjetër përkatës.

Sanksionet e parashikuara në nenin 62/b, paragrafi i parë dhe në nenin 62/c, përcaktohen nga Banka e Shqipërisë.

KREU X/3

ÇEKU I BANKIERIT

Neni 62/e

Nëse një çek përmban klauzolën “me urdhër” emetuar nga një bankë që është e autorizuar nga Banka e Shqipërisë, për një shumë që është në dispozicion të po kësaj banke në datën e lëshimit, çeku i emetuar në këtë mënyrë quhet “çek bankar”.

“Çeku bankar” është i pagueshëm me të parë në çdo sportel të bankave emetuese.

Neni 62/e

Çeku bankar përmban:

- 1.Termin “çek bankar” të shkruar në trupin e instrumentit.
- 2.Premtimin pa kushte për të paguar me të parë një shumë të caktuar parash.
- 3.Emrin e personit, ndaj të cilit kryhet pagesa (prurësi).
- 4.Deklaratën ku jepet data dhe vendi, në të cilin çeku bankar është emetuar.
- 5.Nënshkrimin e bankës që ka emetuar çekun bankar.

Neni 62/f

Nëse në një instrument mungon ndonjë nga kërkesat e përmendura në nenin 62/e, ai është i pavlefshëm si çek bankar.

Mbajtësi i çekut bankar ushtron të drejtën e ankesës, në qoftë se çeku bankar është paraqitur për pagesë nga data e emetimit.

Veprimi i mbajtësit të çekut bankar kundrejt bankës emetuese ndalohet pas tre vjetësh nga data e emetimit të çekut bankar.

Xhirimi ndaj bankës emetuese e shlyen çekun bankar.

Çeku bankar rregullohet më tej nga dispozitat ligjore për çekun.

Koment për nenet 62/e, 62/e,62/f:

Çeku bankar është një titull krediti në urdhër, që përmban një premtim të pakushtëzuar për të paguar në të parë një shumë të përcaktuar parash, i vendosur mbi një formë me kërkesa të veçanta, emetuar nga një institucion krediti i autorizuar për një shumë në dispozicion të tij, në momentin e emetimit dhe i pagueshëm nga çdo bankë korrespondente e tij.

Në nenin 62/e jepen kërkesat në lidhje me elementet e çekut bankar:

1. Përmbajtja e termit “çek bankar” individualizon titullin dhe e dallon nga të tjerët e ngjashëm me të. Vënia e këtij përcaktimi ndalon vënien e shënimeve të tjera mbi çek.
2. Premtimin për të paguar në harmoni me funksionin ekonomik të çekut, i cili nuk mund t’i nënshtrohet asnjë kushti. Çeku bankar paguhet në të parë, që do të thotë, me prezantimin e thjeshtë të tij.
3. Ky lloj çeku bankar ndryshon nga çequet e tjera dhe nuk mund të emetohet “prurësit” për të evituar që çeku të jetë njehsuar me bileta bankare dhe në praktikë për të mos u lejuar institucioneve të kreditit të lëshojnë monedha.
4. Tregimi i datës së emetimit me përfundimin e prezantimit, shërben ndër të tjera për të treguar momentin në të cilin ka nisur detyrimi i emetuesit. Nuk ka ndonjë normë shtesë në rastin kur nuk është treguar vendi i emetimit.

Karakteristika të çekut bankar :

1. Ka formën e premtimit të pakushtëzuar të pagesës të bërë në favor të një personi të përcaktuar.
2. Ka strukturën e formës.
3. Subjektet fillestare janë dy :
 - emetuesi, që është banka që premtion të paguajë;
 - përfituesi që është ai në urdhër të të cilit çeku është emetuar.
4. Është një titull në urdhër; nuk mund t’i jetë lëshuar “prurësit”.
5. Mund t’ju lëshohet edhe personave që nuk kanë llogari rrjedhëse në bankën emetuese.
6. Paguhet në të parë, domethënë, me prezantimin tek banka emetuese.
7. Lëshohet dhe firmoset nga banka vetëm kundrejt derdhjes së shumës korresponduese nga pala kërkuese.

KREU XI

DISPOZITA TË SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE PRIVATE

Neni 63

Zotësia e një personi për t’u detyruar me çek përcaktohet nga ligji i shtetit, i të cilit është shtetas.

Në qoftë se ligji i këtij shteti, cakton se zotësia për t'u detyruar do të përcaktohet nga ligji i një shteti tjetër, do të zbatohet ligji i këtij shteti tjetër.

Personi që nuk ka zotësi për t'u detyruar sipas ligjit të shtetit të tij, do të quhet, megjithatë, i detyruar me çek, në qoftë se nënshkrimin e tij në çek e ka vënë në territorin e një shteti tjetër, ligji i të cilit cakton se personi mund të detyrohet me çek.

Koment:

Në bazë të këtij neni, zotësia juridike dhe zotësia për të vepruar, në kuptimin e tyre juridik, e personave të detyruar me çek, përcaktohet gjithnjë nga ligji i shtetit, shtetas i të cilit është personi.

E njëjta logjikë dhe i njëjti arsyetim përdoret edhe për rastin e shprehur në paragrafin e fundit të këtij neni.

Neni 64

Forma e detyrimeve që rrjedhin nga çeku rregullohet nga ligji i vendit në territorin e të cilit detyrimet u nënshkruan. Megjithatë, është e mjaftueshme që të mbahet forma e caktuar nga ligji i vendit të pagimit.

Në rast se detyrimet e marra me nënshkrimin e çekut nuk janë të vlefshme sipas paragrafit të sipërm, por janë në pajtim me ligjin e vendit ku është nënshkruar një detyrim i mëpasmë, fakti se detyrimet e para janë të pavlefshme nga ana e formës, nuk e bën të pavlefshëm detyrimin e mëpasmë.

Koment:

Në bazë të këtij neni, në marrëdhëniet ndërkombëtare, detyrimet që rrjedhin nga çeku, rregullohen nga ligji i vendit në të cilin është nënshkruar (lëshuar) çeku.

Do të konsiderohet e rregullt përmbushja e detyrimit edhe në rastet kur detyrimet që rrjedhin nga çeku bëhen sipas formës që parashikon ligji i vendit ku paguhet çeku.

Paragrafi i fundit i këtij neni ka të bëjë me rastet kur çeku mund të xhirohet nga një shtet në tjetrin. Në këto raste, nëse xhirimi është bërë në pajtim me ligjin e vendit ku

është bërë xhirimi paraardhës, fakti se xhirimet e tjera pasardhëse janë të pavlefshme nga ana e formës, nuk e bën të pavlefshëm detyrimin që rrjedh nga xhirimi i mëpasëm, i rregullt.

Neni 65

Ligji i vendit, në territorin e të cilit u nënshkruan detyrimet që rrjedhin nga çeku, rregullon efektet e detyrimeve.

Koment:

Ky nen ka lidhje me paragrafin e parë të nenit 64. Kështu, pasojat e detyrimeve që rrjedhin nga çeku, rregullohen nga ligji i vendit në të cilin u nënshkrua (lëshua) çeku.

Neni 66

Afatet për ushtrimin e së drejtës së kthimit caktohen, për të gjithë ata që kanë nënshkruar çekun, nga ligji i vendit ku është lëshuar çeku.

Koment:

Në lidhje me afatet e të drejtës së kthimit ose të regresit, si për rastet e ushtrimit të së drejtës së kthimit, ashtu dhe për rastet e padisë së regresit apo për afatet e parashkrimit të kësaj padie, ato do të rregullohen nga ligji i vendit në të cilin është lëshuar çeku.

Neni 67

Ligji i vendit ku çeku është i pagueshëm cakton:

- a) nëse çeku është nevojërisht në të parë ose nëse mund të lëshohet për një afat të caktuar në të parë, si dhe cilat janë efektet e vënies së datës së mëpasme;**
- b) afatin e paraqitjes;**
- c) nëse çeku mund të pranohet, të vërtetohet, të konfirmohet ose të ketë shënim për paraqitjen e tij dhe cilat janë efektet e këtyre shënimeve;**
- ç) nëse prurësi mund të kërkojë ose nëse detyrohet që të pranojë një pagim të pjesshëm;**
- d) nëse mund të jetë me heqje vijash ose të ketë shënimin “për kalim në llogari”, ose një shprehje me të njëjtin kuptim dhe cilat janë efektet e heqjes së vijave ose të shënimit ose të shprehjes me të njëjtin kuptim;**

dh) nëse prurësi ka të drejtë të posaçme mbi kredinë që ka lëshuesi i çekut kundrejt pritësit dhe cila është natyra e këtyre të drejtave;

e) nëse lëshuesi mund të tërheqë çekun ose nëse mund të kundërshtojë pagimin e tij;

ë) masat që mund të merren në rast humbjeje ose vjedhjeje të çekut;

f) nëse është e nevojshme protesta ose një vërtetim që ka të njëjtën vleftë për të ruajtur të drejtën e kthimit kundër xhiruesve, lëshuesit, ose të detyruarve të tjerë.

Koment:

Ky nen parashikon të gjitha momentet në lidhje me çekun, që rregullohen në bazë të ligjit të vendit ku paguhet çeku.

Neni 68

Forma dhe afatet e protestës, si dhe format e veprimeve të tjera të nevojshme për ushtrimin ose për ruajtjen e të drejtave që rrjedhin nga çeku, rregullohen nga ligji i vendit, në territorin e të cilit bëhen protesta ose veprimi në fjalë.

Koment:

Në bazë të këtij neni, forma dhe afatet e protestës ose të padisë së ngritur për mospagimin e çekut, rregullohen nga ligji i vendit në territorin e të cilit është bërë protesta ose është ngritur padia.

Neni 69

Kur një çek, sipas këtij dekreti, është i pavlefshëm sepse pritësi nuk është një institucion krediti, detyrimet që rrjedhin nga nënshkrimet që janë vënë mbi këtë çek në vende të tjera janë të vlefshme, në rast se në këto vende nuk ndalohej që pritësi i çekut të jetë edhe çdo person.

Koment:

Në bazë të këtij neni, nëse pritësi i çekut nuk është një institucion krediti (sipas përkufizimit të bërë në nenin 54 të këtij dekretligji), detyrimet që rrjedhin nga çeku janë të vlefshme, edhe nëse si pritësi i çekut mund të njihen persona të tjerë, të njohur si të tillë, nga ligji i vendit në të cilin bëhet pagimi i çekut.

KREU XII

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 70

Dispozitat e këtij dekreti zbatohen vetëm për çeqet që do të lëshohen pas hyrjes në fuqi të tij.

Koment:

Kjo është një dispozite e kapërcyer tashmë.

Neni 71

Për çeqet (akreditive) që lëshojnë arkat e kursimit dhe të sigurimeve si dhe për çeqet që mund të lëshojnë zyrat e postave zbatohen dispozitat e veçanta.

Koment:

Kjo është një dispozitë e kapërcyer tashmë.

Neni 59 shfuqizohet.